

20140130331

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR MEDIA

Neni 1

Në Ligjin për media ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 184/13), neni 1 ndryshohet si vijon:

"(1) Me këtë ligj përcaktohen parimet themelore dhe kushtet të cilat duhet të plotësohen nga emetuesit e medieve të përcaktuar me këtë ligj, gjatë kryerjes së veprimtarisë, si dhe sigurimi i mbrojtjes së personave të mitur, redaktorit përgjegjës dhe redaksisë, e drejta e gazetarit që ta shpreh mendimin dhe qëndrimin e tij dhe të refuzojë të zbatojë urdhër, përkatësisht detyrë, mbrojtja e burimit të informatave, impresum, transparenca në punën e emetuesit të medias dhe e drejta e korrigjimit dhe përgjigjes së informatës së publikuar.

(2) Lëndë e këtij ligji nuk janë përmbajtjet që publikohen në media dhe asnjë dispozitë e këtij ligji nuk guxon të interpretohet në mënyrë që do të thotë rregullim i përmbajtjeve."

Neni 2

Në nenin 2 pikat 1 dhe 4 fjalët: "publikime elektronike" shlyhen.

Pika 3 shlyhet.

Pikat 4, 5 dhe 6 bëhen pika 3, 4 dhe 5.

Neni 3

Në nenin 3 paragrafi (2) fjalët: "si dhe media tjera elektronike" shlyhen.

Neni 4

Në nenin 4 pas paragrafit (1) shtohet paragrafi i ri (2), si vijon:

"(2) Ndalimet e veçanta nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të jenë në pajtim me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut."

Neni 5

Në nenin 5 paragrafi (1) fjalët: "ose të emetimit të publikimit elektronik " shlyhen.

Paragrafi (5) ndryshohet si vijon:

"Regjistri i emetuesve të medias së shtypur përmban të dhëna për:

- firmën dhe selinë, përkatësisht emrin dhe adresën e emetuesit të medias së shtypur,
- emrin dhe mbiemrin e personit përgjegjës të emetuesit të medias së shtypur dhe
- emrin e gazetës ose të magazinës."

Neni 6

Në nenin 6 paragrafi (2) shlyhet.

Paragrafi (3) bëhet paragraf (2).

Neni 7

Titulli i nenit 7 dhe neni 7 shlyhen.

Neni 8

Në nenin 8 paragrafi (2) fjalia e parë ndryshohet si vijon:

"Para emërimit ose shkarkimit të redaktorit përgjegjës, emetuesi i medias mund të kërkojë mendim nga redaksia."

Neni 9

Në nenin 9 në fjalinë e parë fjalët: “nëse me aktin nga neni 10 paragrafi (1) të këtij ligji kjo është përcaktuar” shlyhen.

Neni 10

Titulli i nenit 10 dhe neni 10 shlyhen.

Neni 11

Në nenin 11 paragrafi (1) fjalët: “nga neni 10 paragrafi (3) të këtij ligji” shlyhen.

Neni 12

Në nenin 12 paragrafi (3) fjalët: “në mënyrë përcaktuar me aktin nga neni 10 paragrafi (1) të këtij ligji” shlyhen.

Neni 13

Në nenin 14 paragrafi (1) fjalët: “ueb faqen” shlyhen.

Paragrafi (3) shlyhet.

Paragrafi (4) bëhet paragraf (3).

Neni 14

Në nenin 15 paragrafi (2) fjalët: “dhe emetuesit e publikimeve elektronike” shlyhen.

Neni 15

Në nenin 18 paragrafi (3) shlyhet.

Neni 16

Në nenin 29 paragrafi (1) numrat "7" dhe "10" shlyhen.

Neni 17

Në nenin 30 paragrafi (1) pika 2 shlyhet.

Pikat 3, 4, 5 dhe 6 bëhen pika 2, 3, 4 dhe 5.

Neni 18

Në nenin 31 paragrafi (1) pikat 1 dhe 2 shlyhen.

Pikat 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 bëhen pika 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6.

Neni 19

Neni 32 shlyhet.

Neni 20

Në nenin 33 fjalët: “dhe për emetuesit ekzistues të publikimeve elektronike” shlyhen.

Neni 21

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e ardhshme nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".